

HULUMTIM: TREGU I Z I VIAGRËS (1)

ZONAT E ERRËTA TË "PILULAVE MAGJIKE"

Hulumtimi i SCOOP-it, tregoi se si organizatorë të tregëtisë me viagra, paraqiten disa pronarë të depove të barnave në Maqedoni, të cilët këto pilula i importojnë nga Kosova, Bullgaria dhe Greqia, kryesisht me ndihmën e doganierëve, nëpër vendkalimet kufitare ose, nëpërmjet maleve dhe rrugëve jolegale, duke angazhuar, "fshatarët e vendbanimeve kufitare t'i transportojnë me kuaj"

GËZIM SULEJMANI



me kuaj.

Tregëtia ilegale dhe mjaft profitabile me viagra në Maqedoni duket të zhvillohet në një anonimitet të plotë, ndërkohë që askush nuk ndërmer asgjë për ndërprerjen e kanaleve të kësaj tregëtie. Nevoja dhe dëshira për të provuar dhe më pas konsumuar në vazhdimësi "pilulat magjike" ka bërë që ato të jenë shumë të kërkuara nga grupmoshat e ndryshme. Konsumimi i Viagrës në Maqedoni përballet me tabutë e ngritura mbi potencën seksuale. Shumica e përdoruesve i'u shmangen rrugëve legale të konsumimit, duke anashkaluar konsultimet paraprake me mjekët adekuat dhe recetat me të cilat ata lirshëm në barnatore mund të blejnë Viagra.

Ky peisazh bestytë i potencës mashkullore u ka hapur rrugë furnizimeve ilegale të tregut të Viagrës, i cili dita-ditas bëhet më i plotëfuqishëm dhe më i komplikuar. Gati çdo herë në barnatore mund të dëgjohet refreni i njëjtë: "Dua Viagra për një mikun tim". Të gjithë shitësit nëpër barnatore e pohojnë këtë "kod konsumimi". Sipas tyre, pa recetat dhe gjithmonë për dikë tjetër mbetet varianti i blerjes së "pilulave magjike". Ky duket të jetë varianti më lehtë i ilegalitetit të shitjes, përkundër konsumimit në tregun e zi, që tashmë ka ngritur kanale të sofistikuara arkaike të furnizimit me Viagra.

Transporti me kuaj

Hulumtimi i SCOOP-it, tregoi se si organizatorë të tregëtisë me viagra, paraqiten disa pronarë të depove të barnave në Maqedoni, të cilët këto pilula i importojnë nga Kosova, Bullgaria dhe Greqia, kryesisht me ndihmën e doganierëve nëpër vendkalimet kufitare ose nëpërmjet maleve dhe rrugëve jolegale, duke angazhuar fshatarët e vendbanimeve kufitare t'i transportojnë

Jo rrallë herë këto fshatarë nuk janë në dijeni se çfarë transportojnë por as që kanë të drejtë ta inspektojnë mallin. Një mesoburrë, i cili tha se është nga vendbanimet pranëkufitare të Kumanovës, u pajtua të na tregojë rrugët malore nëpërmjet të cilave viagra transportohet ilegalisht nga Kosova në Maqedoni. U prezentua me emrin Don dhe tha se për gjashtë muaj ka transportuar "barna" nëpër kufi, duke mos e ditur se ato janë Viagra. Tha se ka vendosur që të mos merret më me këtë punë, pasi ka filluar se mos vallë është duke bartur ndonjë mall të rrezikshëm.

Sipas tij, personi që ka komunikuar me të ka qenë i autorizuar i njëfarë bossi që furnizon barnatoret e Maqedonisë, me barna që vijnë nga shtetet e përparuar.

"Më ka thënë se këto janë barna efikase për zemrën, por janë shumë të shtrenjta dhe shumë kujdes duhet të bëhet mos të vijë në duar të policisë kufitare për shkak se shteti për këto jep dënime mbi 10 vjet burg", tha Doni, derisa mi tregonte rrugët nëpër të cilat lëvizin kuajt e ngarkuar. Ai tha se në fillim e kanë paguar shumë mirë nga 100 deri në 200 euro për një "hajvan samari", që do të thotë për një ngarkesë me pako të mëdha të maskuara dhe të transportuara me një kal. Ai, para se të fillojë këtë punë iu desh të pranojë rregullat e lojës, të cilat nuk ishin pa rrezik.

"Së pari nëse eventuaisht kapem andej kufirit apo këndeje në asnjë mënyrë s'duhej që të tergojë se për kë punoj dhe ku i transportojmë", thotë ai. Doni rrëfen se ka marrë pastaj edhe leksione se barnat është mirë të transportohen me kuaj të huaj, apo të blehen kuaj të ri dhe në momentin që mundet të dalë përpara ndonjë patrull kufitare dhe kuajt të lihen vet dhe ai të ik. Sipas

tij, kjo bëhej që në rast se patrulla do të ndiqte kuajt, nuk do të kishin mundësi të mbërrijnë në shtëpitë e tyre apo në destinacionin e duhur.

Oferta e doganierit

Tregu ilgal i Viagrës nuk furnizohet vetëm nëpërmjet këtyre rrugëve arkaike. Rrëfimi i një farmacisti nga Maqedonia, i diplomuar në një nga shtetet e perëndimit dhe i edukuar me principet etike të profesionit, fokuson një nyje tjetër furnizimi ilegal me Viagra.

Farmacisti, emri i tij është i njohur për gazetarin, duke kaluar kufirin në një nga shtetet fqinje, punëtori në doganën e Maqedonisë në mënyrë shoqërore e pyet se me çfarë pune merret.

Pas një kontrolli rutinor, doganieri, i kthehet dhe i ofron mundësi për bashkëpunim, në kontrabandë me barna.


"Ti je farmacist? Shumë mirë. Po pse nuk punon me barna, për t'i nxjerë shpenzimet e rrugës, sigurisht do të kishte edhe diçka edhe për mua", rrëfen farmacisti ofertën e doganierit, e cila e ka stepur në vend. Gjatë bisedës doganieri i ka ofruar numrin e telefonit privat dhe orarin e punës për mundësinë e bashkëpunimit me barna ilegale duke kaluar nëpër kufi pa asnjë "therrë në këmbë". Farmacisti thotë se, doganieri më tej e thelloi bisedën duke u motivuar me shifra dhe duke informuar për linjë të mundshme, të cilët mund të lidhen për një biznes profitabil dhe të sigurtë. Sipas farmacistit, ai kishte aluduar në Viagra, në momentin kur kishte folur për "biznesin profitabil". (vazhdon)

(Hulumtimi është realizuar me mbështetjen e SCOOP-it dhe Shoqatës Daneze për Gazetari Hulumtuese)

KSHZ-JA DEFINON AFATET

Fushata zgjedhore më 3 mars

Sipas afateve kohore për realizimin e zgjedhjeve lokale dhe presidenciale që do të mbahen në mars të cilin sot miratoi Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve fushata zgjedhore do të fillojë më 3 mars, theksoi Zoran Tanevski



Fushata zgjedhore do të fillojë më 3 mars ndërsa me 20 janar do të filloj paraqitja e kandidatëve për kryetar komunash dhe president të vendit e cila pritet që të zgjasë 15 ditë.

Kështu tha të hënën zëdhënësi i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Zoran Tanevski i cili publikoi afatet për mbajtjen e zgjedhjeve lokale dhe presidenciale në vend.

"Për kandidatët e interesuar për president, por edhe për kryetar komune dhe këshilltar komunal, afati për mbledhjen e firmave fillon nga data 20 janar dhe do të zgjasë 15 ditë, deri më 3 shkurt në të gjitha njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë. Partitë që nuk kanë mbështetje nga 30 deputetë do të duhet në këtë mënyrë të garojnë në zgjedhjet presidenciale me mbledhjen e 10 mijë firmave. Listat me emrat e kandidatëve për presidenti në KSHZ duhet të dorëzohen përfundimisht deri më 15 shkurt", potencoi Tanevski.

Sipas tij, KSHZ-ja, ka përgatitur edhe padi ndaj partisë "Aleanca maqedonase" e Xhorxhe Atanasovskit dhe partisë së Lazar Elenovskit se kanë filluar fushatën para kohe.

"Sipas afateve kohore për realizimin e zgjedhjeve lokale dhe presidenciale që do të mbahen në mars të cilin sot miratoi Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve fushata zgjedhore do të fillojë më 3 mars. Institucionet kanë të drejtë

të realizojnë anketë deri më 16 mars, ndërsa kërkesa për vëzhgim të zgjedhjeve ka filluar nga 10 janari dhe do të zgjasë deri më 11 mars", bëri publike Taneski afatet zgjedhore.

Ai edhe një herë potencoi kushtet që duhet të plotësoj kandidati për president të vendit, duke u mbështetur në Kushtetutën ekzistuese.

"Sipas Kushtetutës kandidati duhet të jetë të paktën 40 vjeçar, të jetë shtetas i Maqedonisë dhe në 15 vitet e fundit së paku 10 vjet të jetë banor i Maqedonisë dhe të mos jetë i dënuar me vendim të plotfuqishëm me burg më gjatë se 6 muaj", sqaroi Tanevski.

Deri tani vetëm vetëm Lube Boshkovski, ish ministër i punëve të brendshme ka bërë publike kandidaturën e tij në zgjedhjet e ardhshme për postin e presidentit të shtetit, ndërsa asnjë parti politike nuk ka thënë fjalën përfundimtare për kandidatët e tyre.

Siguria në kontroll

Të dy palët gjatë takimit kanë rënë dakord se bashkëpunimi i deritanishëm mes dy forcave të sigurisë është në nivelin e duhur dhe se e njëjta linjë e bashkëpunimit do të vazhdojë edhe në të ardhmen me pretendime për ta intensifikuar të njëjtën edhe më shumë



Ministrja e Punëve të Brendshme të Maqedonisë, Gordana Jankullovska e shoqëruar nga zëvendësi i saj Xhevat Bushi, ka zhvilluar të hënën një takim në Shkup me një delegacion të EULEX-it i udhëhequr nga shefi i saj Yves De Kerambon.

Të dy palët gjatë takimit kanë rënë dakord se bashkëpunimi i deritanishëm mes dy forcave të sigurisë është në nivelin e duhur dhe se e njëjta linjë e bashkëpunimit do të vazhdojë edhe në të ardhmen me pretendime për të intensifikuar atë edhe më shumë.

"Ne e përcjellim gjendjen në komunikimin me kolegët nga ora në orë", deklaroi ministrja Jankullovska e cila

kolegëve të saj nga Kosova, u shkëmbu përvojat maqedonase për luftën kundër krimin të organizuar, korrupsionit dhe krimin ndërkufitar.

"Krimi ndërkufitar nuk njih ndarje etnike dhe politike dhe lufta ndaj saj do të jetë e suksesshme vetëm nëse reagohej në mënyrë të koordinuar", ka theksuar Jankullovska gjatë takimit me delegacionin e EULEX-it.

Nga ana e shefit të misionit EULEX në Kosovë, Kermabon, u premtua se bashkëpunimi mes dy forcave fqinjësore në kufi do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

"Bashkëpunimi jonë në të ardhmen do të vazhdojë me qëllim të intensifikimit të saj. Ne në kontunitet bashkëpunojmë dhe për këtë tregon fakt se gjatë vitit 2008, janë zhvilluar nëntë takime rajonale dhe 200 lokale në bashkëpunim me përfaqësuesit e KFOR-it dhe UMNK-ut", theksoi shefi i EULEX-it Yves de Kerambon.